REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

## KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
## TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga 1116/1 KQ Dibër dhe mban nga dërguesi nr___ prot datë 18.12.2025 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes( lënda)________________

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 4997/1 datë 18.12.2025.

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z________________
-Znj/Z Sekretarit të Këshillit Bashkisë
-Znj/Z________________
-Znj/Z________________

me porosinë:________________
Administrim praktikës sipas ligjit

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes,..etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë ________________ Sipas afateve

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:________________

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

Peshkopi, më 18.12.2025 ________________

4997/1 1116/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1116/1 prot. Peshkopi, më 18.12.2025

**Lënda**: Për vendimin nr.89, datë 05.12.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

**BASHKISË DIBËR**

**KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR**

**DIBËR**

Me shkresën nr.4997, datë 10.12.2025, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër është paraqitur vendimi nr.89, datë 05.12.2025 i Këshillit Bashkiak Dibër me objekt: "Për lënien në fuqi të vendimit nr.78, "Për përdorimin e fondit të akorduar nga Emergjencat Civile, për shpenzimin Blerje karburant".

Lidhur me vendimin "Për përdorimin e fondit të akorduar nga Emergjencat Civile, për shpenzimin Blerje karburant", institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër ka mbajtur qëndrim me shkresën nr.1015/1 datë 10.11.2025.

Në vlerësim të institucionit të Prefektit, vendimi nr.89, datë 05.12.2025, për vetë natyrën e shpenzimit i cili duhet të jetë shpenzim i adresuar në infrastrukturën kritike, nuk është marrë në respektim të kuadrit ligjor, pasi fondi i akorduar nuk provohet të jetë shoqëruar me dokumentacionin përkatës që të provojë shpenzimet e kryera për blerje karburanti në kushtet e përballimit të një situate emergjence civile.

**PREFEKTI**

Nexhbedin SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT DIBËR

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

# VENDIM

**Nr. 89 Datë 05 /12 /2025**

**"Për lënien në fuqi të vendimit nr.78 për përdorimin e Fondit të akorduar nga Emergjencat Civile, për shpenzimin "Blerje karburant "**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore", duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar udhezimit nr.2 . date 24.01.2025 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025" . VKM 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" dhe VKM nr 414 date 08/07/2021 "Per miratimin e kritereve dhe procedurave te ndarjes dhe perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile" pika3.1 germa b,c,gj. Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **05.12.2025** me propozim të Kryetarit të Këshillit shqyrtoi kthimin e VKB Nr.78 nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër nga ku me 16 vota pro 1 kundër 2 abstenim :

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr.78 datë **03 /11 /2025.**
2. Nga fondi i akorduar nga Emergjencat Civile të përdoret për blerje karburant me vlerë financimi 1.200,000 (Njemilion e dyqind mije) lekë:
3. Te perdoret fondi emergjencave civile **10910** në vlerën **1,200,000** (Njemilion e dyqind mije) lekë. Perdorimi i shumes perkatese do te behet ne artikullin 604 programi 10910 e miratuar me shkresen nr.864/1 prot date 27.02.2025 te Ministrise Financave.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e PPECK. Sektori i Prokurimeve Publike dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
5. Ky vendim i dërgohet per dijeni Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
6. Vendimi u shpall më datë **05.12.2025.**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Sokol Sava**

BASHKIA DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiaidber@gmail.com tel:0035521822935